

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Ekonomik
Titulli i lëndës:	Metodologjia e hulumtimeve
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	E obligueshme
Viti i studimeve:	Viti i parë, Semestri i Parë, 2020/2021
Numri i orëve në javë:	2L+0U, L-ligjërata; U-Ushtrime
Vlera në kredi – ECTS:	4 ECTS
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësit e lëndës:	Prof. Dr. Rahmije Mustafa Topxhiu
Përshkrimi i lëndës	
	<p>Kursi është dizajnuar për të zhvilluar fokusin e studenteve në kryerjen e një studimi të mirë duke kaluar nëpër faza të zhvillimit të një propozimi të mirë kërkimor - nga pyetja kërkimore te metodat e hulumtimit deri te zhvillimi dhe testimi i hipotezës dhe përgaditja e projektit kërkimor.</p> <p>Përmes këtij kursi studentët njihen me bazat konceptuale të hulumtimit (konceptet, definicionet, teoritë dhe modelet), metodologjinë dhe strategjinë hulumtuese, llojet e të dhënave dhe analizën e tyre, mostrimin, anketimin dhe dizajnimin e instrumenteve hulumtuese (pyetësor të strukturuar, gjysmë të strukturuar, etj.), parashtrimin e hipotezave dhe formulimin e problemit shkencor dhe zgjedhjen e metodës adekuate hulumtuese dhe testimin e hipotezave. Po ashtu, në këtë kurs studentët njihen me treguesit kryesor statistikor dhe aplikimin e tyre në kuadër të punimeve shkencore.</p> <p>Duke pasur parasysh se hulumtimi dhe analizat kanë vlerë vetëm nëse shtjellohen e paraqiten në formë të qartë e mirë të strukturuar, studentët do të njihen me metodologjinë dhe rregullat e të shkruarit akademik, si dhe me elementet kryesore dhe rregullat për temën e masterit.</p>
Qëllimet e lëndës:	Lënda ka për qëllim të aftësojë studentët për punë në fushën e hulumtimit— mjeshtëri thelbësore për hartimin e punimit të diplomës për arritjen e grades akademike master i shkencës së ekonomisë. Përgajtë këti kursi, studenti fiton përvojë teorike dhe praktike në konceptimin, organizimin dhe zhvillimin e një punimi shkencor duke aplikuar parimet dhe rregullat e shkrimit akademik.
Rezultatet e pritura të nxënies:	<p>Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studentët duhet të jenë në gjendje që të:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikojnë qartë temën e hulumtimit (Research topic) 2. Shfrytëzojnë në mënyrë efektive dhe kritike literaturën shkencore 3. Operacionalizojnë konceptet kryesore në hulumtimin shkencor për të mundur përcaktimin e qëllimeve më të sakta të hulumtimit si dhe për matjet empirike. 4. Formulojnë qartë qëllimet e hulumtimit dhe hipotezat në të cilat do të mbështetet kërkimi shkencor. 5. Formojnë kornizën metodologjike për përgatitjen dhe realizimin e punës empirike në kontekstin e programit të

	<p>studimit duke përcaktuar njësinë, popullatën, listën referuese dhe mostrën e studimit, mënyrat e mbledhjes së të dhënave etj</p> <p>7. Analizojnë të dhënat sasiore dhe cilësore dhe të testojnë hipotezat kryesore të studimit.</p> <p>8. Diskutojnë gjetjet kryesore shkencore që dalin nga kërkimi shkencor në raport me propozicionet teorike në të cilat mbështetet studimi.</p>
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Metoda e punës gjatë dy orëve ligjërata do të përqendrohet në ligjërata dhe diskutime interaktive me pjesëmarrje të studentëve në procesin e mësimit, me prezantime individuale e grupore, të punimeve të ndryshme të përgatitura nga studentët.</p> <p>Studentët inkurajohen që paraprakisht të hulumtojnë dhe lexojnë materiale rreth temave vijuese, në mënyrë që të jenë më të përgatitur në orë të mësimit për të zhvilluar diskutime interaktive në mes të tyre me qëllim të përvetësimit më të shpejtë dhe më të thellë të çështjeve të rëndësishme të metodologjisë së hulumtimeve</p>
-	
Metodat e vlerësimit:	<p>Për të marrë vlerësim pozitiv, studenti duhet të demonstroj se:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) Është i familjarizuar me specifikat e metodologjisë standarde të kërkimeve shkencore. (ii) Mund të aplikoj këtë metodologji në hulumtime shkencore dhe në punimin master. (iii) Mund të aplikojnë rregullat e shkrimit akademik në punime shkencore. <p>Provimi është individual dhe konsiston në një punim që studentët e punojnë gjatë semestrit</p> <p>Punimi i juaj final duhet të përbëhet nga pjesët e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) Një hyrje që motivon temën / pyetjen tuaj kërkimore (ii) Një përmbledhje e literaturës shkencore relevante për temën / pyetjen tuaj (iii) Një përshkrim i modelit tuaj ekonomik dhe hipotezave që do të testohen (iv) Një përshkrim i të dhënave dhe burimeve tuaja (v) Një prezantim i rezultateve tuaja statistikore (duke përdorur grafikë, tabela, etj ...). (vi) Një përfundim që përmbledhë gjetjet tuaja, implikimet e politikave dhe çështje të pazgjidhura për kërkime në të ardhmen. <p><i>(Punimi duhet të ketë 5000 deri në 7000 fjalë).</i></p>
Literatura	
Literatura bazë:	<ul style="list-style-type: none"> (i) Mark Saunders, Philip Lewis and Adrian Thornhill (2019), <i>Research Methods for Business Students</i>, Pearson

	<p>Education Limited, Essex. Eighth edition.</p> <p>(ii) Bob Matthews dhe Liz Ross, (2010), <i>Metodat e hulumtimit - Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe huimane</i>, Pearson Education Limited.</p> <p>(iii) Colin Fisher (2010), <i>Researching and Writing a Dissertation An essential guide for business students</i>, Third edition.</p>
Literatura shtesë:	<p>(i) Rahmije Mustafa Topxhiu: (2016) <i>Hyrje në Statistikë</i>, IFK, Prishtinë.</p> <p>(ii) Bardhyl Ceku & Forcim Kola (2011), <i>Metoda kërkimi</i>, Fakulteti i Biznesit, universiteti “Aleksandër Moisiu, Durrs.</p> <p>(iii) Douglas A. Lind. William G.Marchal, Samuel A. Wathen, (2013), Basic Statistics for Business & Economics, Eighth Editon, McGraw-Hill/Irwin, International Edition, New York.</p> <p>(iv) Dr Catherine Dawson (2009), <i>Introduction to Research Methods: A Practical Guide for Anyone Undertaking a Research Project</i> Fourth Edition</p>
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e parë:</i>	Prezantimi i Syllabusit dhe çështjet që lidhen me organizimin e mësimit gjatë semestrit.
<i>Java e dytë:</i>	Hyrje në metodologjinë hulumtuese: Konceptet, definicionet, teoritë dhe modelet.
<i>Java e tretë:</i>	<i>Diskutim rreth detyrës së parë (prezantime nga ana e studentëve)</i>
<i>Java e katërt:</i>	Formulimi dhe qartësimi i temës hulumtuese- disa udhëzime praktike
<i>Java e pestë:</i>	Rishikimi kritik i literaturës
<i>Java e gjashtë:</i>	<i>Diskutim rreth detyrës së dytë (prezantime nga ana e studentëve)</i>
<i>Java e shtatë:</i>	Koncepte, korniza konceptuale dhe teoritë
<i>Java e tetë:</i>	Formulimi i dizajnit kërkimor
<i>Java e nëntë:</i>	Mbledhja e materialit hulumtues Sigurimi dhe grumbullimi i të dhënave: përcaktimi i madhësisë së mostrës, përzgjedhja e mostrës, dizajnimi i pyetësorëve.
<i>Java e dhjetë:</i>	Anketimi: metodologjia, databaza dhe inspektimi i të dhënave, Gabimet gjatë grumbullimit të të dhënave
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Shfrytëzimi i të dhënave dytësore
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Metodat kualitative: përcaktimi i rasteve për hulumtim, përgatitja e pyetësorëve, diskutimeve në fokus grupe, studimet e rastit, raportimi i të dhënave nga analizat kualitative.

<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Analiza e të dhënave përmes statistikave përshkruese si mesatarja, mesorja, moda, vlerat extreme (outliers), mospërgjigjet në pyetje, koeficienti i korrelacionit, paraqitjet grafike, etj.	
<i>Java e katermbëdhjetë:</i>	Shkrimi akademik: struktura, organizimi i punimit, paragrafet, argumentet, vështrimi kritik, përfundimi, plagjarizmi në punime shkencore	
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Hartimi dhe prezantimi i raportit kërkimor nga ana e studentëve	

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja e rregullt dhe aktive në ligjëratat dhe në ushtrime; - Respektimi i orarit të ligjëratave dhe ushtrimeve. - Ç'kyçja e telefonave celular dhe mbajtja e qetësisë në mësim.